



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë, 11.10/2012  
Nr. 0204 -1050

PËR: Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut  
Sinan Gacaferi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË  
KOMUNËS SË JUNIKUT, Pranuar me datën: 03/10/2012


Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimeve Nr.001/19; Nr.001/21; Nr.001/20; Nr.01/18 të miratuara me datë 03.08.2012 **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre akteve dhe vlerëson se të njëjtat janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Aktet juridike të listuara si vijon, kanë efekt të plotë juridik.

- Vendim për ndryshimet e Logos së Komunës së Junikut Nr.001/19;
- Vendim për dhënien e Betimit të Anëtares së re të Kuvendit të Komunës së Junikut Nr.001/21.
- Vendim për plotësimin e Anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa Nr. 001/20
- Vendim për Miratimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis Nr.01/18

Me respekt,

*për*   
Slobodan Petrović,  
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së  
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana, 11.10/2012  
Br.0204 -1050

Za: Agron Kuçi, Gradonačelnik Opštine Junik  
Sinan Gacaferi, Predsedavajući Skupštine Opštine Junik

Predmet: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKA OPŠTINE JUNIK, Prilmljeno dana: 03/10/2012


Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluka br.001/19; br.001/21; br.001/20; br.01/18 usvojenih dana 03.08.2012 **POTVRDJUJE** zakonitost ovih akata i pocenjuje da su ista u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravna Akta navedena u nastavku, imaju puni pravni efekat

- Odluka o promeni Logoa Opštine Junik br.001/19;
- Odluka o davanju zakletve nove članice Skupštine Opštine Junik Br.001/21.
- Odluka o popunjavanju sa članovima Odbora za Politiku i Finansije Br. 001/20
- Odluka o usvajanju lokalnog Plana za delovanje u sredinu br.01/18

S poštovanjem,

  
Slobodan Petrović,  
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

**Kopija:** Besnik Osmani, Generalni Sekretar u MALS-a  
Direktorima uprava i kancelarija  
Arhivi MALS-a

HYRESE-GLAZRA-KOMUNITETIT  
 REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
 Ministry of Local Government Administration

Data  
 Datum 03.10.2012  
 Date

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- III -	2204-1050		



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Titulli i Post.	Nr. i Kart.	Data
04-566P	II	03.10.2012



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

### Kuvendi i Komunës

Nr. 001/19

Data: 13.08.2012

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), dhe neni 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010) Kuvendi i Komunës në Junik në mbledhjen e mbajtur : 03.08.2012, mori këtë:

## VENDIM

### PËR NDRYSHIMIN E LOGOS SE KOMUNËS SE JUNIKUT

- Me këtë vendim ndryshohet Logo (Stema) e Komunës së Junikut.

#### Arsyetim

Ideja e ndryshimit të Logos (Stemës) ka dalë si pasojë mungesës së elementeve esenciale të cilat duhet ta karakterizojnë Logon e Komunës së Junikut, dhe me qëllim të prezantimit të identitetit kulturorë - historik të Junikut me veçoritë e tij unike.

Stema e Komunës së Junikut, nuk është e realizuar me kodin e ngjyrave heraldike dhe nuk ka formësim artistik, sepse nuk shprehë blazonin e ngjyrave dhe nuk e ka alfabetin e mburojës normane.

Duhet theksuar se dy komponentet figurative (simbole bazike), siç janë lumi dhe kulla janë prezantuar në stemë si kundërshtim me realitetin objektiv. Kështu, lumi Erenik është vizatuar si udhë malore në perspektivë. Ky është një gabim heraldik, sepse egjiptianët e vjetër edhe para 4000 vjetëve lumin Nil e kanë paraqitur qartas me vijë lakore horizontale. Kjo mënyrë e trajtimit prej shkrimit hieroglif është bartur në shenja të gjeografisë, e më vonë ka hy në kodin heraldik të stematografisë.

Ndërsa, në këndin e majtë të mburojës është paraqitur një e treta e kullës, e cila krijon jo baraspeshë estetike, sepse elementet në tërësinë e sipërfaqes janë pa kompozicion. Kulla është dashur të paraqitet e plotë në VENDIN E NDERIT, e akorduar në simetrinë e mburojës, si simbol i jetës dhe i qëndresës.

Stema aktuale e Junikut nuk ka sistem të aplikueshëm në vulë të thatë, në vullë me ngjyra, në relief guri, në relief metal, dhe në hapësirë (të kufizuar) flamuri. Prandaj, stema i ngjanë më tepër një shenji për pikë turistike se një identiteti administrativ.

Veçoritë dalluese (karakteristikat parësore) të një vendbanimi që është ngritur në njësi administrative-komunale duhet të paraqiten në simbol identiteti, me ndihmën e komponentëve figurative-aplikative, duke u mbështetur rreptësisht në rregullat shkencore të heraldikës.

Në bazë të kësaj që e shpjeguar më lartë konstatojmë se stema e Junikut si e tillë duhet hequr nga përdorimi, sepse Juniku e meriton me besueshmërinë më të madhe një emblemë të vërtetë simbolike.

II. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohet:

- MAPL,
- Arkiva.





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr. Prot.	Nr. i hco	Data
2-4-6795	1	26-09-2012



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/21

Datë: 13.08.2012

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), dhe neni 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr: 001/3127, të datës: 29.9.2010) Kuvendi i Komunës në Junik në mbledhjen e mbajtur me datë: 03.08.2012, mori këtë:

## V E N D I M

PËR DHENIEN E BETIMIT TË ANETARËS SE RE TE KUVENDIT TE  
KOMUNËS SË JUNIKUT

- I. Me këtë vendim anëtarja znj. Besiade Gjocaj, pas dhënies se betimit emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Junik.
- II. Mandati i saj do te zgjat deri ne përfundimin e mandatit te Kuvendit te zgjedhur me zgjedhjet lokale ne 2009-2010.
- III. Ky Vendim hyr në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohet:

- MAPL,
- E emëruara,
- Arkiva.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik - Opština Junik		
QZ/Nr-Post	Nr i treg	Data
26-6121	1	13.08.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës  
Nr. 001/20  
Datë: 13.08.2012

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), dhe neni 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr: 001/3127, të datës: 29.9.2010) Kuvendi i Komunës në Junik në mbledhjen e mbajtur me dt: 03.08.2012, mori këtë:

## V E N D I M

### PËR PLOTESIMIN E ANËTAREVE TE KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

- I. Me këtë vendim emërohet këshilltarja e Kuvendit komunal në Junik, Ajete Gjuli anëtare Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe njeherit plotësohet numri i anëtareve të kërkuar sipas procedurave ligjore.

#### Arsyetim

Pas dorëheqjes me vet dëshirë të anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa Leonita Jasiqi, dhe konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligji Nr. 03/L-07, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Kuvendi Komunal në Junik vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

- II. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohet:

- MAPL,
- E emëruara,
- Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit  
Z. Sinan Sakaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA Komuna Junik - Opština Junik		
QZ/No Post	Posteo	Data
2-4-5662	1	15.08.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY JUNIK

Kuvendi i Komunës  
Nr. 01/18  
Datë: 13.08.2012

Ne baze të nenit 24 paragrafi 1. të ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (Ligji Nr.03/L-025, CZRK 50/2009); nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji nr.03/ L-040, CZRK 28/2008); nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statusit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, Kuvendi I Junikut në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 03.08.2012. merr këtë :

VENDIM  
PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL PËR VEPRIM NË MJEDIS

- I. Me këtë Vendim miratohet Plani Lokal për Veprim në mjedis/ në tekstin e mëtejme: Plani/
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet komuna e Junikut në bashkëpunim me komunitetin, kompanitë publike dhe institucionet e tjera të cilat kanë të bëjnë me Planin
- III. Me Miratimin e këtij Vendimi shfuqizohen vendimet e mëparshme me të cilat kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi I Junikut. në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis.
2. REC
3. Arkivi komunal.



Presuesi i Kuvendit  
Sinan Gacaferi